REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 156/1 Prot

Datë 31 /01 /2024

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

Referuar kërkesës suaj protokolluar me Nr.156 Prot datë 17.01.2024 drejtuar institucionit tonë, ju bëjmë me dije si mëposhtë:

1. Numri i akteve ligjore që janë konsultuar me organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2023 ka qënë 4 (Buxheti për vitin 2024, Paketa Fiskale, PBA dhe prioritetet për thirrjet e reja për Programin Reload2)
2. Forma e konsultimit ka qënë dëgjesë publike (prezantim i draftit nga ana e bashkisë dhe diskutimi me të gjithë pjesëmarrësit) me target grupe të ndryshme .
3. Numri i OJF-ve që kanë marrë pjesë në konsultime është 5.
4. Bashkia Përmet ka Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik i publikuar edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Përmet apo dhe platformën konsultimivendor.al

   Koordinatori i Konsultimit Publik
   Albion Naska
   Email: albion.naska@bashkiapermet.gov.al
   Tel: 0693326048

5. Bashkia Përmet nuk ka koordinator për Shoqërinë Civile
6. Pranë Bashkisë Përmet përvec Këshillit Bashkiak nuk ka organe të tjera këshillimore.
7. Nuk ka
8. Gjatë vitit 2023, Bashkia Përmet i ka patur OJF-të partnere në aktivitete, nisma dhe vendimmarrje. Qëllimi i bërjes pjesë të grupeve të përbashkëta është bërja pjesë e të gjitha targeteve dhe dëgjimi i zërit të të gjitha grupeve. OJF pjesëmarrëse janë të ndryshme në varësi të projekt/nismës që ndërmerret duke qënë konform edhe veprimtarisë që ushtron secila OJF.
9. Stafi i Bashkisë Përmet nuk është trajnuar për veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve përvec 3 personave që janë trajnuar për thirrjet publike që Bashkia hap në kuadër të

programit Reload , thirrje për projekt propozime nga OJF-të për prioritete që përcaktohen nga konsultimi i Bashkisë me OJF-të që veprojnë në Përmet.

10. Bashkia Përmet nuk ofron licensa për shërbime të caktuara që ofrohen nga OJF-të.

Duke ju falenderuar,

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Denisa DURRO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Tel &Faks: +355 813 22275; 22254; Email: info@bashkiapermet.gov.alweb: www.bashkiapermet.gov.al

Bazuar në shkresën tuaj drejtuar Bashkisë Përmet, protokolluar me tonën Nr 529 Prot datë 21.02.2024, në respektim të Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë :

1. OJF-të aktive në Përmet kanë përfituar fonde nga Bashkia Përmet. Tashmë prej disa vitesh, Bashkia Përmet hap thirrje publike në kuadër të Programit Reload dhe financon projektpropozime (grante) sipas prioriteteve të përcaktuara në kosultim me shoqatat.
2. Gjithësej në vitin 2023 kanë aplikuar 4 shoqata të cilat kanë marrë financim.
3. 4 shoqata kanë përfituar gjithësej :

Shoqata	Fondi	Viti
Floemi	990,000 lekë	2023
Mjedis Ujra, Pyje	1,000,000 lekë	2023
Vjosa Explorer	2,000,000 lekë	2023
Përmeti Futboll Klub 1930	2,000,000 lekë	2023

4. Bashkia Përmet i konsideron jo vëtëm Ojf-të por edhe bizneset si partner të rëndësishëm dhe bashkëpunimi ka qënë prezent në cdo nismë të tyre apo edhe të Bashkisë.
5. Mbështetja ka qenë kryesisht me ambiente dhe staf në raste trajnimesh, aktivitete të përbashkëta, bashkëpunime në nisma të ndryshmë dhe të rëndësishme për komunitetin si mbjellja e pemëve , pastrami mjedisit etj.

Faleminderit, punë të mbarë!

Koordinatore për të drejtën e informimit : Angjelina Nakuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 46/1 Prot . Përmet më 18 .01 2024

Lënda : Kthim përgjigje

Bazuar në shkresën tuaj Nr 42 prot , datë 05.01.2024 protokolluar me tonën Nr 46 prot ,datë 08.01.2024 ,lidhur me përcjelljen e informacionit mbi procesin e konsultimit të Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2024-2026 si dhe Buxhetit 2024.
Procesi i Konsultimit Publik është një proces i rëndësishëm për miratimin e dokumentave të rëndësishëm si Programi Buxhetor Afatmesëm, Buxheti Vjetor dhe Paketa Fiskale.Përsa i përket informacionit të kërkuar nga ana juaj ju paraqesim të dhënat si më poshtë :

- Në procesin e konsultimit janë njoftuar :
    1. Komuniteti i qytetit dhe Njësive Administrative
    2. Biznese lokale (të vogla dhe të mëdha)
    3. Operatorë turistike, startupe
    4. Të rinjtë
    5. Gra sipërmarrëse dhe jo vetëm
    6. OJF që veprojnë në qytetin e Përmetit

Në total janë njoftuar mbi 100 persona për çdo konsultim.

- Në konsultim kanë marrë pjesë rreth 30 individë për çdo takim.
- Gjatë procesit të konsultimit komentet e grupeve të interest janë mbajtur në Procesverbal nga koordinatori për Konsultimin Publik dhe nga vet drejtuesit e Programeve Buxhetore.Këto procesverbale janë publikuar edhe në faqen online konsultimivendor.al .
- Buxhetimi gjinor është përfshirë në programet buxhetore, në vlerën 1570000 lekë.
- Sesionet e konsultimit publik kanë zgjatur rreth 120 minuta, në varësi të diskutimit edhe më pak osë më shumë.

Duke ju falenderuar per bashkëpunimin!

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
DENISA DURRO

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al,www.bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 15/1 **Prot** Përmet,më; 12 /01 .2023.

Lënda; Kthim përgjigje.

Në përgjigje te shkresës Tuaj me nr. 187/23 datë: 28.12.2023, e rregjistruar me tonën me nr 15 prot. datë: 03.01.2024 me objekt: "*Kërkesë për informacion dhe vënie e dispozicion e dokumentacionit*" si dhe në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Ligj nr 119 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar

ju bëjmë me dije se:

Bashkia Përmet ka disa kontrata me OSHE, (*114 te tilla*) të ndara sipas objekteve në varësi të saj si: Arsimi e kultura (*shkolla, kopeshte-cerdhe, objekte social-kulturore, etj*) objektet në varësi të saj: Godina e Bashkisë, godinat Nj.Ad, godina adminstrative në varësi të Bashkisë, Ndricimi publik rrugor, stacionet e pompimit etj. Në kërkesën tuaj nuk specifikohet nëse duhen shpenzimet për konsum të energjise për të gjitha kontratat apo vetëm për godinen e insitucionit të Bashkisë.

Sa më sipër:

Po ju dërgojmë konsumin e energjisë e kërkuar vetem për institucionin e Bashkisë për periudhën 01.10.2023 deri në 20.10.2023 sipas **tabelës 1**. bashkëlidhur kësaj shkrese:

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

BASHKIA PERMET

Tabela 1

Objekti	Kontrata	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**Total**	KW
Viti 2021															
Zyrat e Bashkise	**F18044**										22259,2	45544	67669,6	**135.473**	8.064
Viti 2022														-	-
Zyrat e Bashkise	**F18044**	69.602	62.697	44.603	31.331	11.944	34926,4	12784	319	22544,8	17286	27433,6	43208,8	**378.680**	22.540
Viti 2023														-	-
Zyrat e Bashkise	**F18044**	59.051	70.223	49.828	38.303	17.270	16883,2	42150,4	45174,4	21335,2	15774,4			**375.993**	22.381

Re

M

Pershendetje,
Ne pergjigje te emailit tuaj bashkelidhur gjeni ne format exel secilin preventiv per cdo banese qe eshte shpallur fituese nga Ministria e Financave , Drejtoria e Strehimit.
Po keshtu ne kete link https://openprocurement.al/sq/tender/view/id/53007 do te gjeni cdo dokument te publikuar ne SPE nga AK Bashkia Pemret dhe njoftimin perfundimtar te fituesit ne kete procedure.
Faleminderit!

---- On Mon, 15 Jan 2024 14:01:14 +0100 te ---

[redacted]

1 Attachment(s) · Download as Zi

PREVENTIV PA CMIME PE... .xlsx
123.1 KB

Përshendetje
Në pergjigje të emailit tuaj për informacion ju bejmë me dije si më poshtë:
1. Buxheti i parashikuar për artin dhe kulturën për vitet 2022-2023 është 1000000 Lekë
2. Ky buxhet është alokuar për organizatat e shoqërisë civile në kuader të programit Reload.
3.Për një informacion më te detajuar të gjitha të dhenat e nevojshme i gjeni në faqen zyrtare të bashkisë : www.bashkiapermet.gov.al .
Punë të mbarë!

Koordinatore për të drejtën e informimit : Angjelina Nakuçi.

Re: Fwd: Kërkesë për Leje Xhirimi - Emisioni "Destinacioni X" në Ujërat Termale të Benjes, 21 Prill 2024 Kthim përgjigje

ME Me <ngjelina.nakuci@bashkiapermet.gov.al>
Tue, 19 Mar 2024 2:24:16 PM +0100 •

To "Info Bashkia Permet" <info@bashkiapermet.gov.al>

Reading 1 / 2

Në pergjigje të emailit tuaj ju bëjmë me dije se ujrat termal të Bënjës jan ë pjese e teritorit të parkut kombëtar "Bredhi i Hotoves" , si i tillë ky teritor është nën administrimi dhe menaxhim të zonave të mrojtura . për trajtimin e kërkesës tuaj duhet ti drejtoheni Administratës së Zonave të Mbrojtura Gjirokastër . Për informacion drjetori i parkut është Grigor Dushi nr telefoni 0696621191 Faleminderit , punë të mbarë !

Koordinatore për të drejtën e informimit : Angjelina Nakuçi

---- On Mon, 18 Mar 2024 12:15:01 +0100 **Info Bashkia Permet <info@bashkiapermet.gov.al>** wrote ---

[redacted]

Përshëndetje!
Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju informoj si më poshtë:
1. Çdo 5 vite Bashkia Përmet kryen një pagesë pranë AKEP për domainin "bashkiapermet.gov.al" në vleren 5000 lekë.Për mirëmbajtje hosti kryejmë një pagesë vjetore rreth 100000 lekë për kompaninë që mirëmban web-in.
2.Bashkia Përmet ka program transparence të miratuar. Me urdhër të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr 211 datë 10.09.2018 .Bashkia Përmet ka miratuar Programin e Transparencës i cili është publikuar në faqen web të bashkisë dhe update-ohet çdo seksion sipas ndryshimeve të sektorëve.
3.Kërkesa për informim të ardhura elektronikisht i gjeni në sesionin:
- Transparenca
- Kërkesë për informacion
-Rregjistri i kërkesave për informacion

Duke ju falenderuar !

Koordinatore per te drejten e informimit : Angjelina Nakuçi